



## REPUBLIKA E SHQIPËRISE

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVATË  
Zyra Përmbarimit Privat "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. Nipt L81722046V  
Rruga "Brigada VIII" Pallati Tekno Projekt, Hyrja 1, Kati IV, Ap.24, Tirane  
E-mail: [ervinkryeziu01@gmail.com](mailto:ervinkryeziu01@gmail.com) Mob: +355692127662

Nr.784 Dosje  
Nr. 169 .Prot.

Tiranë më datë. 16/02 /2022

### VENDIM

Unë Ervin Agron Kryeziu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës Përmbarimit Privat "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në referim të Vendimit për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.Regj.Them 1156 (31134-03703-80-2019) datë 10.06.2019, i lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për zbatimin e Titullit Ekzekutiv *Vendim Përfundimtar i Inspektimit Nr.06 datë 23.04.2018 me Nr.Serie 0000156*, të Inspektoriatit Shtetëror i Mjedisit Pyjeve Ujrave dhe Turizmit, Dega Rajonale Tiranë, është vënë në ekzekutim ky Urdhër, duke u regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.784 Datë 21.08.2019, kërkesa e kreditorit **Inspektoriatit Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, Dega Rajonale Tiranë** për vënie në ekzekutim ndaj debitorit **Shoqërisë "ELIDA - 2017" sh.p.k me Nr.NIPT K97807301D me administrator z.Flamur Sotiri.**

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

### KONSTATOVA

Në vijim të veprimeve procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit ndaj debitorit Shoqërisë "ELIDA - 2017" sh.p.k., pranë Zyrës Përmbarimit Privat "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. është protokolluar shkresa Nr.5425 Prot. datë 29.07.2020 me objekt "Dërgim Informacioni" e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Me anën e kësaj shkrese Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në mbështetje të VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" informon përmbaruesit gjyqësor të cilët janë në proces ekzekutimi të titujve ekzekutiv të lëshuara nga ISHMPUT, se struktura e ISHMPUT-së në nivel qendror dhe rajonal shkrihet tërësisht dhe komponentët e fushës së saj të përgjegjësisë shpërndahen në disa institucione si më poshtë:

Referuar VKM-së nr.568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" funksionet e inspektimit tematik që lidhen me fushën e Mjedisit dhe Ujërave, kalojnë në fushën e përgjegjësisë së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Sa i takon dosjeve përmbarimore që janë në proces ekzekutimi që lidhen me këtë fushë, të kalojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Rezulton se që prej datës 30.07.2020 të dërgimit të shkresës së sipërcituar të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e deri më sot, shkresë në të cilën është bërë zëvendësimi i palës kreditore nga ISHMPUT në AKM, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në cilësinë e palës kreditore nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural në mbështetje të nenit 184 të të K.Pr.Civile me Zyrën e Përmbarimit Privat "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k.

Ndodhur në kushtet kur, pas kalimit të afatit procedural nga pala kreditore nuk është kryer asnjë veprim si më sipër cituar dhe Zyra Përmbarimit Privat "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k nuk mund të vijoj me kryerjen e veprimeve për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, bazuar në nenin 148 të K.Pr.Civile.

Përsa më sipër në referim të Nenit 515, 617 të Kodit të Proçedurës Civile si dhe të ligjit nr. 26/2019 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".



## VENDOSA

### 1. Kthim e Akteve AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT, si më poshtë :

- Vendimi për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.Regj.Them 1156 (31134-03703-80-2019) datë 10.06.2019, i lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë **(në origjinal)**

- Titullin ekzekutiv *Vendim Përfundimtar i Inspektimit Nr.06 datë 23.04.2018 me Nr.Serie 0000156*, të Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, Dega Rajonale Tiranë **(fotokopje)**

- Proçesverbal i Inspektimit me Nr.Serie 0000125, Datë 11.04.2018 të Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, Dega Rajonale Tiranë **(fotokopje)**

### 2. Të ndërpresë veprimet përmbareme për ekzekutimin e Vendimit për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.Regj.Them 1156 (31134-03703-80-2019) datë 10.06.2019, i lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për zbatimin e Titullit Ekzekutiv *Vendim Përfundimtar i Inspektimit Nr.06 datë 23.04.2018 me Nr.Serie 0000156*, të Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, Dega Rajonale Tiranë.

### 3. a) Urdhërohen Bankat Tregetare të Nivelit II, të zhblokohen menjëherë nga masa e sekuestros konservative depozitat, kredite apo llogarite bankare të Shoqërisë “ELIDA - 2017” sh.p.k me Nr.NIPT K97807301D dhe të z.Flamur Sotiri, atësia Nako, i datëlindjes. 12.01.1946, me Nr.ID E60112058L (administrator i shoqërisë “ELIDA - 2017” sh.p.k), të bllokuara me shkresën Nr.9108 Prot. Datë 16.09.2019, dhe me shkresën Nr.13880 Prot. Datë 27.12.2019 të Zyrës Përmbaremit Privat “BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k. me Përmbareues Gjyqësor Elvin Hoxha.

b) Urdhërohet Qendra Kombëtare e Biznesit, të zhblokojë nga masa e sekuestros konservative menjëherë bllokimin kuotat/aksionet e Shoqërisë “ELIDA - 2017” sh.p.k me Nr.NIPT K97807301D me administrator z.Flamur Sotiri, bllokuar me shkresën Nr.9111 Prot. Datë 16.09.2019 të Shoqërisë Përmbaremit Privat “BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k. me Përmbareues Gjyqësor Elvin Hoxha.

c) Urdhërohet Regjistri i Barrës Siguruese të zhblokojë menjëherë nga barra siguruese dokumentacionin e Mjeteve me Nr.Shasie: **VF634FPA000001171**, prodhuesi **RENAULT KERAX 450 DX 34FPA**, i vitit **2007**, dhe me Nr.Shasie: **VF634FPA000000668**, prodhuesi **RENAULT KERAX 450 DX 34FPA**, i vitit **2008**, të regjistruara në pronësi të Shoqërisë “ELIDA - 2017” sh.p.k., me Nr.NIPT K97807301D (me emërtimin e mëparshëm shoqëria “FRANGAJ – KONSTRUKSION” sh.p.k.), të bllokuara me shkresën Nr.4753 Prot. Datë 29.05.2020, të Zyrës Përmbaremit Privat “BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k. me Përmbareues Gjyqësor Elvin Hoxha.

### 4. Ky vendim mbahet në disa kopje dhe u njoftohet palëve të përfshira në këtë proçes, të cilat kanë të drejtën e ankimit gjyqësor brenda 5 (pesë) - ditëve, duke filluar që nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

**ZYRA PËRMBARIMIT PRIVAT “BAILIFF SERVICE E.HOXHA” sh.p.k.**  
**PËRMBARUES GJYQËSOR**  
**ERVIN KRYEZIU**

